



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Raporti i Auditimit të Pajtushmërisë

**“NDËRTIMI I SHTËPIVE PËR PJESËTARËT
E KOMUNITETEVE JO SHUMICË NË
KOMUNA” NË MINISTRINË E
ADMINISTRIMIT TË PUSHTETIT LOKAL
PËR VITIN 2024**

Zyra Kombëtare e Auditimit, në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit të sektorit publik kryen auditime vjetore financiare dhe pajtueshmërisë të detyrueshme me ligj si dhe auditime të performancës.

ZKA përmes auditimeve ofron informacion cilësor mbi përdorimin e fondeve publike të cilat ndihmojnë entitetet e audituara të përmirësojnë sistemet e tyre të menaxhimit financiar dhe kontrollit, duke rritur transparencën dhe llogaridhënien, parandalimin e korrupsionit dhe përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të fondeve publike. Njëkohësisht, kjo do të shtojë vlerë veprimtarisë së tyre operative dhe strategjike. Në këtë mënyrë, ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Ne përmes raporteve të auditimit kemi ofruar një pamje të qartë se si qeveria dhe institucionet publike kanë menaxhuar me shpenzimet dhe të ardhurat, pasurinë publike dhe qeverisjen në nivel të vendit.

Ne kemi vlerësuar efektivitetin dhe efikasitetin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, përdorimin e drejtë të burimeve dhe sistemeve tjera në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal. Fushë me rëndësi të cilës Zyra Kombëtare e Auditimit i kushton vëmendje çdo vit, është edhe ajo e menaxhimit të procesit të subvencionimit, kjo duke pasur parasysh që është ndër fushat kryesore të shpenzimeve. Këto auditime kanë rol të rëndësishëm me ndikim që të rritet transparenca dhe efikasiteti në menaxhimin e shpenzimeve, si dhe me qëllim që të rritet edhe vlera për parane e shpenzuar përmes subvencioneve.

Ky auditim është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA 4000). Auditimet e pajtueshmërisë të ndërmarra nga Zyra Kombëtare e Auditimit janë shqyrtime objektive dhe të besueshme që vlerësojnë nëse veprimet qeveritare, sistemet, operacionet, programet, aktivitetet ose organizatat veprojnë në përputhje me autoritetet.

Auditorja e Përgjithshme ka vendosur në lidhje me përmbajtjen e raportin të auditimit “Ndërtimi i shtëpive për pjesëtarët e komuniteteve jo shumicë në komuna”.

Përbërja e ekipit të auditimit:

Mjellma Dibra Morina, Drejtore e Auditimit;

Fjolla Bakalli Sadiku, Udhëheqëse e ekipit; dhe

Sabile Muli, Anëtare e ekipit.

TABELA E PËRMBAJTJES

PJESA I. PËRMBLEDHJA E PËRGJITHSHME	3
PJESA II. LËNDA E AUDITUAR DHE FUSHËVEPRIMI	4
2.1. TITULLI DHE ENTITETI I AUDITUAR	4
2.2. PERIUDHA E AUDITIMIT	4
2.3. ARSYESHMËRIA DHE BAZA LIGJORE PËR KRYERJEN E AUDITIMIT	4
2.4. STANDARDET E PËRDORURA TË AUDITIMIT	4
2.5. PËRSHKRIMI I LËNDËS SË AUDITIMIT DHE FUSHËVEPRIMIT TË AUDITIMIT	4
2.6. OBJEKTIVAT E AUDITIMIT	5
2.7. KRITERET E AUDITIMIT	5
PJESA III. GJETJET	7
PJESA IV. KONKLUZIONET	11
PJESA V. REKOMANDIMET	12
PJESA VI. PËRGJIGJET NGA ENTITETI I AUDITUAR	13

PJESA I. PËRMBLEDHJA E PËRGJITHSHME

Zyra Kombëtare e Auditimit ka kryer auditimin e pajtueshmërisë për procesin e subvencionimit “Ndërtimi i shtëpive për komunitetet jo shumicë në komuna”, aktivitet që është zhvilluar përmes thirrjes publike të shpallur nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) me datë 01.02.2024. Ky program është financuar nga buxheti i ministrisë për të cilin ishin ndarë mjete në vlerë prej 3,000,000€, dhe ka pasur për qëllim përmirësimin e kushteve të jetesës për pjesëtarët e komuniteteve jo shumicë në gjendje të rëndë ekonomike dhe sociale.

Objekti i auditimit ishte vlerësimi i pajtueshmërisë së këtij procesi në raport me kornizën ligjore, rregulloret dhe dispozitat e thirrjes publike në të gjitha fazat e zbatimit të projektit: nga planifikimi dhe shpallja e thirrjes, deri te përzgjedhja e përfituesve, implementimi i subvencionit dhe ekzekutimi i fondeve.

Konkluzioni i auditimit është se edhe pse projekti ka arritur të sigurojë mbështetje për një numër të caktuar përfituesish, procesi nuk ka qenë plotësisht i harmonizuar me kërkesat për ligjshmëri, transparencë dhe barazi.

Sa i përket procesit të planifikimit, aktiviteti për ndërtimin e shtëpive ishte zhvilluar jashtë planit vjetor të punës dhe objektivave strategjike të ministrisë, si dhe pa miratim të një rregulloreje të brendshme që përcakton procedurat.

Procesi i përzgjedhjes së përfituesve nuk ishte në pajtueshmëri me kriteret e thirrjes publike. Janë evidentuar përfitues të përzgjedhur pa dokumentacion të plotë, trajtim i pabarabartë i aplikantëve me kushte të njëjta, vendime të pa bazuara nga komisioni i ankesave si dhe mungesë e dokumentimit të vizitave në terren nga komisioni vlerësues.

Sa i përket procesit të implementimit të subvencionit, në dy raste ndërtimi i shtëpive nuk u realizua sipas afateve dhe kushteve kontraktuale. Megjithatë këto raste u evidentuan dhe u raportuan nga komisioni monitorues, ministria nuk ka ndërmarr masat ndëshkuese të parapara me kontratë.

Për adresimin e mangësive të identifikuara, është e domosdoshme ndërmarrja e veprimeve konkrete, për të cilat janë dhënë rekomandime për Ministrin.

PJESA II. LËNDA E AUDITUAR DHE FUSHËVEPRIMI

2.1. TITULLI DHE ENTITETI I AUDITUAR

Auditimi i pajtueshmërisë ka të bëjë me auditimin e procesit të subvencionimit të “Ndërtimit të shtëpive për komunitetet jo-shumicë në komuna”, proces ky i zhvilluar nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) si subjekt përgjegjës për planifikimin, menaxhimin, mbikëqyrjen dhe zbatimin e këtij projekti.

2.2. PERIUDHA E AUDITIMIT

Periudha e auditimit mbulon vitin 2024, përkatësisht periudhën e zbatimit të projektit nga momenti i shpalljes së thirrjes publike deri në fazën e përfundimit të ndërtimit të shtëpive dhe ekzekutimit të pagesave përfundimtare (Shkurt – Dhjetor 2024).

2.3. ARSYESHMËRIA DHE BAZA LIGJORE PËR KRYERJEN E AUDITIMIT

ZKA ka mandat kushtetues dhe ligjor, për t’i audituar programet dhe projektet e menaxhuara nga organizatat buxhetore dhe të financuara nga Buxheti i Kosovës. Auditimi është kryer në përputhje me Ligjin Nr 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, neni 2, si dhe Planit Vjetor të Auditimit të ZKA-së për 2024/2025. Në bazë të ligjit të ZKA-së, të gjitha raportet e auditimit bëhen publike në web-faqen zyrtare.

2.4. STANDARDET E PËRDORURA TË AUDITIMIT

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit dhe praktikat e mira. Në përputhje me SNISA 100 – Parimet themelore të auditimit në sektorin publik, SNISA 400 – Parimet themelore të auditimit të pajtueshmërisë, dhe SNISA 4000 – Standardet e auditimit të pajtueshmërisë, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e pajtueshmërisë, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti nën auditim. Dëshmitë e auditimit të mbledhura janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për sigurimin e konkluzioneve të auditimit.

2.5. PËRSHKRIMI I LËNDËS SË AUDITIMIT DHE FUSHËVEPRIMIT TË AUDITIMIT

Lënda e auditimit ka të bëjë me procesin e subvencionimit të “Ndërtimit të shtëpive për komunitetet jo-shumicë në komuna”, të financuar dhe zbatuar nga MAPL.

Ky aktivitet është zhvilluar në bazë të thirrjes publike, që kishte për qëllim mbështetjen e pjesëtarëve të komuniteteve jo shumicë në komuna në gjendje të rëndë ekonomike dhe sociale, me qëllim të krijimit të kushteve adekuate të banimit. Mjetet e ndara në vitin 2024 për financimin e kësaj thirrje ishin 3,000,000€.

Tabela 1. Buxhetimi dhe shpenzimi i mjeteve lidhur me projektin

Përshkrimi	Buxheti i ndarë	Shpenzimet	Ndryshimi/Mbetja	% e realizimit
Projekti: Ndërtimi i shtëpive për komunitetet jo-shumicë në komuna	3,000,000€	2,291,189€	708,812€	76

Aktiviteti ka përfshirë ndërtimin e gjithsej 50 shtëpive me model standard, përfituesve të të cilave u është dhënë subvencioni në vlerë të barabartë prej 46,474.42€ secili. Vlera totale e pagesave të ekzekutuara nga ministria për këtë qëllim ishte 2,291,189€. Prej tyre, 48 shtëpi kishin përfunduar, ndërsa dy të tjera nuk kishin përfunduar ende.

Auditimi i pajtueshmërisë ka pasur për qëllim të vlerësojë pajtueshmërinë e këtij aktiviteti me kornizën ligjore, dispozitat e thirrjes publike dhe me marrëveshjet kontraktuale.

Auditimi është përqëndruar në tre faza kryesore të procesit: 1. planifikimin e aktivitetit, duke shqyrtuar nëse subvencionimi është paraparë në dokumentet strategjike, planin vjetor dhe buxhetin e ministrisë; 2. përzgjedhjen e përfituesve, për të vlerësuar nëse janë respektuar kriteret ligjore sipas thirrjes publike si dhe procedurat e aplikimit, vlerësimit dhe aprovimit; si dhe 3. implementimin, ku është analizuar ndërtimi i shtëpive, zbatimi i kushteve kontraktuale, pagesat në faza dhe procesi i mbikëqyrjes.

Nuk janë evidentuar kufizime në fushëveprimin e auditimit.

2.6. OBJEKTIVAT E AUDITIMIT

- Të vlerësohet nëse aktiviteti i subvencionimit të ndërtimit të shtëpive për komunitetet jo shumicë në komuna është planifikuar në përputhje me objektivat strategjike, me planin vjetor të punës si dhe janë siguruar burimet e mjaftueshme financiare për realizimin e projektit;
- Të vlerësohet nëse procesi i përzgjedhjes së përfituesve është bërë në përputhje me kriteret ligjore duke respektuar parimet e transparencës dhe trajtimit të barabartë; si dhe
- Të vlerësohet nëse procesi i implementimit të subvencionit, rrjedhimisht përdorimi i fondeve për ndërtim të shtëpive është bërë në përputhje me marrëveshjet e nënshkruara dhe kushtet e kontraktuara ndërmjet ministrisë, përfituesve dhe punë kryesve, si dhe nëse janë arritur objektivat e synuara të subvencionimit.

2.7. KRITERET E AUDITIMIT

Kriteret e auditimit bazohen në pajtueshmërinë me:

- Ligjin Nr. 03/L-047 për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës;
- Ligjin Nr.08/L-260 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2024;
- Rregulloren (MF) nr. 01/2019 për menaxhimin financiar dhe kontrollin;

- Rregulloren (QRK) nr.14/2023 për fushat e përgjegjësisë administrative të zyrës së kryeministrit dhe ministrive;
- Planin strategjik institucional 2024 – 2026 si dhe Planin vjetor të punës së MAPL-së;
- Kriteret obligative të publikuara në Thirrjen publike për ndërtimin e shtëpive për pjesëtarët e komuniteteve jo shumicë në komuna (data e publikimit: 01.02.2024); dhe
- Marrëveshjet kontraktuale në mes palëve (MAPL-së, përfituesit dhe operatorëve ekonomik ndërtues).

PJESA III. GJETJET

Mangësitë e identifikuar në procesin e planifikimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së përfituesve, si dhe në implementimin e subvencionimit janë pasqyruar përmes gjetjeve të auditimit të cilat bazohen në analizimin e dokumenteve relevante për secilin proces.

3.1 Procesi i planifikimit:

Në këtë fazë është vlerësuar nëse procesi i planifikimit të aktivitetit të subvencionuar ishte në përputhje me planin vjetor të organizatës, buxhetin e miratuar dhe objektivat strategjike.

Në vijim janë shpalosur çështjet e identifikuar:

Çështja I Realizimi i aktivitetit jashtë planit vjetor dhe mungesë e rregullore për menaxhim të subvencioneve

Plani Strategjik Institucional 2024 – 2026 përfshinë objektivat specifike dhe operacionale të MAPL-së. Krahas planit strategjik, Plani Vjetor i Punës së ministrisë përmban objektivat dhe aktivitetet e planifikuara vjetore që lidhen me përgjegjësitë dhe fushëveprimin e ministrisë.

Më tujte, Rregullorja nr. 09/2011 e punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës (e shfuqizuar në qershor të vitit 2024) përkatësisht neni 38 Rregullat dhe procedurat për hartimin dhe shqyrtimin e projektligjeve dhe akteve nënligjore, paragrafi 6 përcakton: Ministri ka autoritet për miratimin e akteve nënligjore që bien në përgjegjësinë dhe brenda kompetencave të ministrisë. Po ashtu, Rregullorja e re Nr. 17/2024 e punës së qeverisë së Republikës së Kosovës, neni 9.2 përcakton: Ministri me vendim nxjerr akte nënligjore të nevojshme për zbatimin e ligjeve duke u bazuar në autorizimin ligjor, e që bien në fushën e përgjegjësisë administrative të ministrisë.

Aktiviteti i zhvilluar nga ministria për subvencionimin e “Ndërtimit të shtëpive për komunitetet jo shumicë në komuna” nuk është përfshirë në planin vjetor të punës së ministrisë, dhe as në dokumentet strategjike të saj. Megjithatë për këtë aktivitet kishte mjete financiare të ndara me Ligjin e buxhetit të vitit aktual, plani financiar nuk ishte në përputhje me aktivitetet e planifikuara në planin vjetor, duke krijuar mospërputhje ndërmjet dokumenteve planifikuese.

Për më tepër, ministria nuk kishte hartuar rregullore të brendshme ose akte nënligjore për të rregulluar procedurat e zhvillimit të këtij aktiviteti edhe pse ky ishte viti i dytë për ministrinë që zhvillon një aktivitet të tillë.

Shkaku

Kjo gjendje ishte rezultat i mangësive në procesin e koordinimit të planifikimit strategjik dhe vjetor, mungesës së analizës së bazës dhe përgjegjësisë ligjore përpara ndërmarrjes së aktivitetit, si dhe mos hartimit të akteve nënligjore të nevojshme për të udhëhequr zbatimin e këtij aktiviteti.

Ndikimi

Zhvillimi i aktiviteteve jashtë fushëveprimit ligjor dhe pa rregullore të miratuara rrezikon legjitimitetin dhe transparencën e përdorimit të fondeve publike. Po ashtu mund të ketë ndikim në shpenzime jo efikase dhe devijim të burimeve nga objektivat strategjike dhe prioritetet e ministrisë.

3.2. Procesi i përzgjedhjes së përfituesve

Kjo fazë përfshin publikimin e thirrjes për aplikim me kriteret e obligueshme, themelimin e komisioneve përkatëse, shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve sipas kriterëve të përcaktuara, procesin e shqyrtimit të ankesave dhe përmbillet me publikimin e listës përfundimtare të përfituesve.

Në vijim kemi paraqitur çështjet e identifikuara:

Çështja 2 Mangësi në procesin e përzgjedhjes së përfituesve

“Thirrja publike për ndërtimin e shtëpive për pjesëtarët e komuniteteve jo shumicë në komuna” e publikuar me date 01.02.2024 kishte për qëllim që pjesëtarëve të komuniteteve jo shumicë në komuna, të cilët janë në gjendje të rëndë ekonomike dhe sociale, dhe të cilët nuk kanë kushte adekuate të banimit, të ju krijohen kushte normale për jetesë. Në këtë thirrje janë përcaktuar kriteret obligative dhe dokumentet e kërkuara për aplikim për mbështetje.

Në kuadër të kësaj thirrje për mbështetje financiare kishin aplikuar gjithsej 500 kandidatë, prej të cilëve në listën përfundimtare ishin përzgjedhur 51 përfitues të cilët kishin plotësuar kriteret sipas komisionit vlerësues. Një përfitues është tërhequr gjatë procesit, konkretisht në fazën e nënshkrimit të kontratës me operatorin ekonomik ndërtues.

Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të aplikuesve, kemi identifikuar se:

- Dy përfitues janë përzgjedhur pa plotësuar kriterin e posedimit të pronës për ndërtimin e shtëpisë. Megjithatë aplikuesit kishin sjellë dëshmi pronësore, ato nuk ishin në emër të aplikuesit. Rrjedhimisht, nuk janë siguruar dokumente relevante të pronësisë apo vërtetim i noterizuar mbi disponueshmërinë e saj sipas dokumentacionit të kërkuar në thirrjen publike. Për njërin nga këto raste, bashkë me komentet e entitetit dhe me dorëzimin e Letërkonfirmimit, është ofruar dëshmia pronësore.
- Trajtim jo i barabartë i aplikantëve me kushte të njëjta të aplikimit, përfshirë edhe dokumentacionin. Kjo ka bërë që vendimi i komisionit mbi vlerësimin e tyre të jetë i ndryshëm, duke përzgjedhur apo refuzuar aplikantët pa një bazë të qartë të vlerësimit. Lidhur me këtë:
 - ✓ Në thirrjen publike një nga kërkesat teknike ishte të sigurohet certifikata e lindjes së aplikuesit. Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit kemi konstatuar se 58 aplikantë ishin refuzuar për të vetmen arsye se kishin siguruar ekstraktin e lindjes në vend të certifikatës së lindjes. Në anën tjetër, ne evidentuam 9 përfitues të subvencionit, që kishin aplikuar në mënyrën e njëjtë, pra vetëm me ekstrakt të lindjes dhe ishin përzgjedhur; si dhe
 - ✓ Në dy raste, përfituesit ishin refuzuar për aplikacione të pa nënshkruara dhe jo të plota. Ndërsa, në anën tjetër, ne evidentuam dy raste të përfituesve të përzgjedhur, njëri me aplikacion të panënshkruar dhe tjetri me aplikacion jo të plotë.
- Nga gjithsej aplikantët që kishin plotësuar kriteret obligative teknike, 43 raste janë përjashtuar nga komisioni pas vizitave në terren, me arsyetimin se kushtet e banimit aktual të tyre ishin të pranueshme për jetesë. Lidhur me këtë proces komisioni ka përpiluar vetëm një listë përmbledhëse të këtyre aplikantëve, por nuk ekzistonte dokumentacion mbështetës nga vizita në terren (raporte të nënshkruara nga anëtarët e komisionit dhe fotografi nga vizita në terren). Kjo ka pamundësuar verifikimin e transparencës së këtij procesi.

Shkaku

Mangësitë e evidentuara kanë ndodhur në mungesë të një rregulloreje apo procedurave të brendshme që standardizojnë këtë proces, si dhe në mungesë të mekanizmave efektiv të mbikëqyrjes dhe kontrollit.

Ndikimi

Përzgjedhja e përfituesve që nuk i kanë plotësuar kriteret dhe përdorimi i standardeve të ndryshme të vlerësimit gjatë këtij procesit ka rezultuar në trajtim jo të barabartë të aplikantëve duke rrezikuar ligjshmërinë, integritetin dhe besueshmërinë e procesit. Po ashtu, dokumentimi jo i mjaftueshëm pamundëson verifikimin dhe cenon transparencën përgjatë procesit të vlerësimit.

Çështja 3 - Vendime kontradiktore në procesin e subvencionimit

Me vendim të Sekretarit të Përgjithshëm të ministrisë është formuar Komisioni për shqyrtimin e ankesave të lidhura me “Thirrjen publike për ndërtimin e shtëpive për pjesëtarët e komuniteteve jo shumicë në komuna”. Ky komision kishte mandat të shqyrtonte ankesat e pranuar bazuar në kriteret e përcaktuara dhe të merrte vendime për aprovimin ose refuzimin e tyre.

Kemi vërejtur se në disa raste janë nxjerrë vendime kontradiktore në mes të komisionit të vlerësimit dhe atij të ankesave. Katër aplikantë, të cilët fillimisht ishin refuzuar nga komisioni i vlerësimit me arsyetimin se nuk i plotësonin kriteret, kishin drejtuar ankesë për shqyrtimin e këtij vendimi. Mirëpo, në procesin e shqyrtimit të ankesave janë refuzuar me arsyetimin se ndonëse i plotësojnë kriteret, nuk ka mjete financiare të mjaftueshme për t’i mbështetur të gjithë aplikantët.

Megjithatë, nga mjetet e ndara sipas thirrjes publike dhe vendimit të ministrit, për mbështetjen e këtij aktiviteti ishin të ndara 3,000,000€ dhe kostoja e planifikuar për 51 përfitues të përzgjedhur nga komisioni vlerësues ishte 2,370,195€ (46,474.42€ për secilin përfitues). Rrjedhimisht, kishte mjete të lira për mbështetje edhe të një numri shtesë të aplikantëve që i kanë plotësuar kriteret.

Shkaku

Kjo gjendje ka ardhur si rezultat i përdorimit jo të qartë të kriterëve ligjore dhe administrative. Si dhe, mungesa e harmonizimit dhe qartësisht të procedurave dhe kriterëve të vlerësimit të aplikantëve dhe ankesave.

Ndikimi

Vendimet e pa bazuara të komisioneve kanë rezultuar në përjashtimin e aplikantëve që i kishin plotësuar kriteret e përcaktuara, duke cenuar parimin e barazisë dhe transparencës në procesin e subvencionimit.

3.3. Procesi i zbatimit të subvencionit

Kjo fazë përfshin nënshkrimin e kontratave midis Ministrisë dhe përfituesve, kontratat e përfituesve me operatorët ekonomikë ndërtues, procesin e ekzekutimit të pagesave si dhe procesin e mbikëqyrjes nga komisioni monitorues, duke siguruar zbatim të projektit në përputhje me kushtet kontraktuale.

Në vijim janë shpalosur çështjet e identifikuara:

Çështja 4 – Mos ndërmarrja e veprimeve për mos zbatimin e kushteve të kontratës nga përfituesit

Neni 3 i kontratës për subvencionimin e ndërtimit të shtëpisë, i lidhur midis ministrisë dhe përfituesit të subvencionit, përcakton vlerën totale të financimit prej 46,474.42 € dhe kushtet e pagesës. Paga realizohet në tre faza: 50% pas nënshkrimit të kontratave dhe dorëzimit të konfirmimit të llogarisë bankare, 30% pas dorëzimit të dokumentacionit dhe dëshmimeve për shpenzimet e pjesës së parë dhe miratimit nga komisioni monitorues, si dhe 20% pas dorëzimit të dokumentacionit dhe dëshmimeve për përfundimin e ndërtimit të shtëpisë dhe raportit final të komisionit monitorues.

Neni 2.3 i kontratës parasheh: Vlefshmëria e kontratës përfshinë periudhën kohore prej momentit të nënshkrimit të kontratës deri te ekzekutimi i pagesës së fundit dhe dorëzimi i shtëpisë në shfrytëzim, por nuk mund të jetë më gjatë se 120 ditë kalendarike.

Më tej, neni 5.3 i kësaj kontrate specifikon se nëse MAPL vëren se mjetet e ndara financiare sipas kësaj kontrate nuk janë duke u përdorur sipas kushteve të kontratës dhe qëllimit të tyre, projektit unik sipas Aneksit 1 dhe planit dinamik sipas Aneksit 2, ka të drejtë dhe obligim që të kërkojë kthimin e mjeteve të shpenzuara.

Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit në këtë fazë, janë identifikuar dy raste të përfituesve që nuk iu ishin përmbajtur kushteve kontraktuale. Ndërtimi i shtëpive nuk kishte përfunduar deri në kohën e ekzekutimit të auditimit, dhe ekzaminimit në terren që është zhvilluar në muajin gusht të vitit 2025, pavarësisht se kontratat me përfituesit ishin nënshkruar më 23.04.2024. Ndërkohë që kanë kaluar 16 muaj nga nënshkrimi i kontratës, ende nuk ishte ndërmarrë ndonjë masë nga ana e ministrisë për mos zbatim të kushteve të kontratës dhe qëllimit të saj.

- Në njërin rast, përfituesit i ishte paguar avansi 50%, në vlerë 23,237.21€, por ai nuk kishte dorëzuar dokumentacionin dhe dëshmitë për shfrytëzimin e këtyre mjeteve në ministri. Pas verifikimit të gjendjes në terren, ekipi i auditimit ka konstatuar se shtëpia ishte në fazë përfundimtare, megjithëse përfituesi nuk kishte kërkuar fare pjesën tjetër të mjeteve nga ministria.
- Në rastin tjetër, përfituesit i ishte ekzekutuar 80% e pagesës, në vlerë prej 37,179.54€, pas miratimit nga komisioni monitorues, por përfituesi nuk kishte zbatuar dispozitat e kontratës pas pranimit të kështit të dytë. Nuk kishte dorëzuar dokumentacionin dhe dëshmitë për shfrytëzimin e mjeteve dhe përfundimin e ndërtimit të shtëpisë.

Komisioni monitorues kishte raportuar për gjendjen e shtëpive të papërfunduara, por ministria nuk kishte ndërmarrë masat e parashikuara në kontratë për mospërmbushjen e kushteve kontraktuale.

Shkaku

Kjo ka ndodhur për shkak të mos ndërmarrjes së masave nga ministria për të adresuar mospërmbushjen e kushteve kontraktuale, edhe përkundër raportimit nga ana e komisionit.

Ndikimi

Kjo situatë rrit rrezikun e shfrytëzimit joefektiv të fondeve, duke vënë në dyshim qëllimin kryesor të mbështetjes përmes thirrjes publike: përmirësimin e kushteve adekuate të banimit për raste të rënda ekonomike dhe sociale.

PJESA IV. KONKLuzionet

Bazuar në gjetjet e prezantuara në raport mund të konkludojmë se:

4.1. Sa i përket procesit të planifikimit, aktiviteti i zhvilluar për “Ndërtimin e shtëpive për pjesëtarët e komuniteteve jo shumicë në komuna” nuk ishte në pajtueshmëri me dokumentet strategjike të planifikimit, si dhe nuk ishin nxjerrë rregullore për menaxhimin e procesit.

Aktiviteti i subvencionuar “Ndërtimi i shtëpive për komunitetet jo shumicë në komuna” është zhvilluar jashtë planit vjetor të punës dhe objektivave strategjike të ministrisë. Ministria nuk kishte nxjerrë rregullore ose procedura të brendshme për të rregulluar procesin e zhvillimit të këtij aktiviteti, pavarësisht se aktiviteti është zhvilluar për dy vite me radhë. Kjo gjendje reflekton mangësi në koordinimin e planifikimit strategjik dhe vjetor, si dhe në analizën e kompetencave ligjore, duke rritur rrezikun e përdorimit joefektiv të fondeve dhe devijimit të burimeve nga objektivat prioritare të ministrisë.

4.2. Sa i përket procesit të përzgjedhjes së përfituesve, përkatësisht vlerësimi dhe shqyrtimi i ankesave të aplikantëve nga komisionet nuk ishte në pajtueshmëri me “Thirrjen publike për ndërtimin e shtëpive për pjesëtarët e komuniteteve jo shumicë në komuna” të datës 01.02.2024.

Procesi i përzgjedhjes së përfituesve nuk është zhvilluar në pajtueshmëri të plotë me kriteret e thirrjes publike. Janë evidentuar raste të përfituesve që nuk i kanë plotësuar kriteret, trajtim i pabarabartë i aplikantëve me kushte të njëjta, si dhe mungesa e dokumentimit të vizitave të kryera në teren nga komisioni i vlerësimit, ka rritur rrezikun e vendimmarrjes subjektive duke e cenuar besueshmërinë e procesit.

Procesi i shqyrtimit të ankesave ka rezultuar me vendime të pabazuara, duke mos respektuar dispozitat e përcaktuara në thirrjen publike si dhe vendimin e ministrit për ndarje të mjeteve. Përkundër faktit që kishte mjete të disponueshme për të mbështetur aplikantë shtesë që kishin plotësuar kriteret, komisioni i ankesave ka refuzuar disa prej tyre me arsyetimin e mungesës së fondeve. Kjo ka dëmtuar parimin e barazisë, ka krijuar trajtim të padrejtë ndaj aplikantëve dhe ka cenuar transparencën e procesit.

4.3. Sa i përket procesit të zbatimit të subvencionit, edhe përkundër që ndërtimi i shtëpive në dy raste nuk ishte në pajtueshmëri me kushtet e parapara në kontratë, nuk ishin ndërmarrë masa ndaj përfituesve.


Nga shqyrtimi i fazës së zbatimit u konstatua se dy përfitues nuk kishin përfunduar ndërtimin e shtëpive brenda kushteve kontraktuale dhe nuk kishin dorëzuar dokumentacionin e nevojshëm për shpenzimin e mjeteve të pranuar. Megjithatë komisioni monitorues kishte raportuar për këto devijime, Ministria nuk kishte ndërmarrë masat ndëshkuese të parapara në kontratë, duke krijuar rrezik për shfrytëzim joefektiv të fondeve publike dhe mosrealizim të qëllimit të mbështetjes.

PJESA V. REKOMANDIMET

Me qëllim të adresimit të çështjeve të identifikuara dhe për të siguruar mbarëvajtje të proceseve nga faza e planifikimit e deri te zbatimi i subvencionit, si dhe duke u bazuar në mangësitë e identifikuara me këtë auditim ne rekomandojmë si në vijim. Ministri duhet të siguroj që:

1. Të gjithë aktivitetet e subvencionuara të përfshihen në planin vjetor dhe objektivat strategjike, si dhe të nxjerrë rregullore ose të hartoj procedura të brendshme që standardizojnë zhvillimin e këtij aktiviteti. Gjithashtu, duhet të përmirësohet koordinimi ndërmjet planifikimit strategjik dhe buxhetor për të siguruar transparencë dhe përdorim efikas të fondeve publike.
2. Të aplikoj mekanizma më efikase në përzgjedhjen e përfituesve si dhe të vendosë kontrolle efektive për të shmangur trajtimin e pabarabartë të aplikantëve. Përveç kësaj, komisioni vlerësues të siguroj dokumentim të plotë dhe të verifikueshëm për vizitat në terren duke përpiluar raporte të nënshkruara, evidenca fotografike etj.
3. Komisioni i ankesave të ushtrojë kujdes të shtuar në marrjen e vendimeve, duke siguruar zbatimin e një procedure të unifikuar dhe të qartë për trajtimin e ankesave, në mënyrë që vendimmarrja të jetë në përputhje me kriteret dhe dispozitat e përcaktuara në thirrjen publike.
4. Të forcojë mekanizmat e zbatimit të kontratave duke ndërmarrë me kohë masat e përcaktuara ndaj përfituesve që nuk përmbushin obligimet, me qëllim të përdorimit të drejtë të fondeve dhe përmbushjes së qëllimit të subvencionimit.

PJESA VI. PËRGJIGJET NGA ENTITETI I AUDITUAR



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm në raportin e auditimit të "Ndërtimi i shtëpive për pjesëtarët e komunitetit jo shumicë në komuna" dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për Auditimin e Pajtueshmërisë "Ndërtimi i shtëpive për pjesëtarët e komunitetit jo shumicë në komuna" i zbatuar nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, për periudhën 2024 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- nuk pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe kam komente për përmbajtjen e Raportit;
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Jeton Qela

pen

Sekretar i Përgjithshëm, MAPL

Data: 22.10.2025

Shtojca Nr 1: Përgjigjet e entitetit të audituar në lidhje me konkluzionet e raportit

Vëzhgimet/ Rekomandimet	Pajtohet Po/Jo	Komentet e entitetit të audituar	Përgjigja e ZKA-së
Rekomandimi 2: Të aplikoj mekanizma më efikase në përzgjedhjen e përfituesve si dhe të vendosë kontrolle efektive për të shmangur trajtimin e pabarabartë të aplikantëve. Përveç kësaj, komisioni vlerësues të siguroj dokumentim të plotë dhe të verifikueshëm për vizitat në terren duke përpiluar raporte të nënshkruara, evidenca fotografike etj.	Jo	Lidhur me dy (2) përfitues pa plotësuar kriterin e posedimit të pronës - për njërin rast, është dërguar Kontrata e shitblerjes së pronës tek ZKA, ndërsa për rastin e dytë Komisioni i përzgjedhjes dhe Komisioni i monitorimit, asnjëherë nuk kanë hasur në probleme të pronësisë, deri në përfundim të shtëpisë, dhe si rezultat shtëpia është përfunduar dhe familja që ishte shumë në nevojë për shtëpi, tash jeton në shtëpi të re, deri tani MAPL nuk ka pranuar ndonjë ankesë lidhur me këtë rast. Lidhur me certifikatën e lindjes apo ekstraktin e lindjes - rastet e refuzuara përveç mungesës së certifikatës apo ekstraktit të lindjes kanë pasur dhe mungesa të dokumentacioneve tjera, në praktik gjitha aplikacionet që kanë pasur dokumentet e tjera dhe ka pasur njërin nga këto dokumente ekstrakt apo certifikatë të lindjes, aplikacionet e këtyre aplikative janë pranuar nga Komisioni. Lidhur me dy (2) aplikacione të pa nënshkruara janë refuzuar të gjitha aplikacionet e pa nënshkruara, në përjashtim të rasteve në fjalë, të cilat për arsye të ngarkesës së madhe, i'u kanë ikur komisionit, mirëpo janë raste të cilat gjatë vizitës në terren, është konstatuar gjendja shumë e rëndë dhe e domosdoshme për ndërtim të shtëpive. Nga vizitat në teren është vrenjtur se rastet e refuzuara kanë qenë raste ku kushtet e tyre të banimit kanë qenë më të përshtatshme për vazhdimin e jetesës në ato shtëpi dhe gjendja e tyre nuk ka qenë po aq e rëndë sa e përfitueseve të kësaj thirrje publike, disa nga rastet janë refuzuar për arsyeje se disa nga aplikantët kanë aplikuar vetëm për rinovimin e shtëpive aktuale, e cila nuk ka qenë pjesë e kësaj thirrje publike, po ashtu disa raste kryesisht në komunën e Prizrenit, është konstatuar se hapësira e tokës për ndërtimin e shtëpisë ka qenë	Komenti i entitetit paraqet arsyetime të përgjithshme për mënyrën e zhvillimit të procesit, por nuk është i mbështetur me dëshmi relevante. Ekipi i auditimit ka shqyrtuar tërësisht dokumentacionin përkatës përmes mostrave të auditimit dhe ka konstatuar gjendjen siç është përshkruar në këtë raport. Andaj, pavarësisht komenteve të dhëna, kjo nuk e ndryshon gjendjen e konstatuar në raportin e auditimit.

		me e vogël se m2 të parapara për ndërtim të shtëpisë, për çka e ka bërë të pa mundur ndërtimin e shtëpisë, lidhur me këto përveç listës me sqarimet për secilin rast me arsyet e refuzimit Komisioni vlerësues ka bërë edhe disa fotografi në teren të cilat janë prezantuar edhe ZKA.	
Rekomandimi 4: Të forcojë mekanizmat e zbatimit të kontratave duke ndërmarrë me kohë masat e përcaktuara ndaj përfituesve që nuk përmbushin obligimet, me qëllim të përdorimit të drejtë të fondeve dhe përmbushjes së qëllimit të subvencionimit.		Njëri nga rastet (në komunën e Mitrovicës së Veriut) për arsye të ndërprerjes së punimeve nga operatori ekonomik (probleme shëndetësore) është vonuar procesi i ndërtimit dhe pas vizitës së komisionit të monitorimit dhe vizitës së njëjtë komision së bashku me anëtarët e ZKA-së është konstatuar se shtëpia është përfunduar e gjitha për kundër faktit që përfituesi nuk ka marrë pjesën e dytë të mjeteve. Rasti tjetër (në komunën e Dragashit) për arsye të terrenit jashtëzakonisht të vështirë ka qenë e pa mundur që të përfundohen punimet nga operatori ekonomik me kohë. Duke u bazuar në qëllimin e kësaj thirrje publike për subvencionimin e ndërtimit të shtëpive për pjesëtarët e komuniteteve jo shumicë në Republikën e Kosovës, me gjende të vështirë ekonomike, edhe pse ka vonesa në implementimin e projektit qëllimi i kësaj thirrje publike, në këto dy raste është arritur dhe përfituesit janë duke jetuar në këto shtëpi.	Komenti i entitetit paraqet arsyetime për vonesat në përfundimin e ndërtimit, por nuk e ndryshon gjendjen e konstatuar lidhur me moszbatimin e kushteve kontraktuale.

Zyra Kombëtare e Auditimit
Lagjja Arbëria
Rr. Ahmet Krasniqi, 210
10000 Prishtina
Republika e Kosovës